



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL
DREJTORIA JURIDIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Tiranë, më 08.10.2020

NJOFTIM PUNËSIMI

Në zbatim të Vendimit nr. 877, datë 14.12.2016, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 719, datë 31.10.2014 të Këshillit të Ministrave “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, me Urdhër të Kryeministrit nr. 156, datë 18.11.2019 “Për disa ndryshime në Urdhrin nr. 140 datë 17.09.2018 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, në përputhje me Urdhrin nr. 20, datë 19.01.2018 “Për krijimin e sporteleve unike të shërbimeve për fermerët-Agropika”,

➤ SPECIALIST INFO-APLIKIM NË AGROPIKËN KORÇË

Detyrat kryesore të Specialistit Info-Aplikim janë:

- Të japë informacion dhe të promovojë programet e skemave mbështetëse kombëtare për bujqësinë dhe zhvillimin rural.
- Të japë informacion dhe të promovojë programet e skemave mbështetëse për bujqësinë dhe zhvillimin rural të financuar nga Bashkimi Evropian (IPARD II), si dhe donatorë të tjerë.
- Të japë informacion mbi Fondet e Garancisë dhe lehtësirat financiare që ofrojnë tregjet bankare dhe financiare për fermerët.
- Të japë informacion mbi politikat e zhvillimit të sektorit bujqësor dhe blegtoral.
- Të japë informacion mbi tregjet bujqësore dhe blegtorale.
- Të kryejë regjistrimin e të dhënave të fermës bujqësore dhe blegtorale sipas sistemeve të vëna në funksion.
- Të bëjë pranimin e aplikimeve për mbështetjen financiare nga fondet e skemave kombëtare.
- Të bashkëpunojë me zyrat shtetërore, bashkitë, bankat, donatorët apo grupet e fermerëve/shoqatave për ofrimin e shërbimeve.
- Të raportojë pranë AZHBR qendër në mënyrë periodike.
- Të raportojë problematikat apo idetë dhe kërkesat e fermerëve

Kandidatët e interesuar duhet të përmbushin këto kritere:

1. Të kenë mbaruar arsimin e lartë universitar, niveli Bachelor.
(Diplomat e marra jashtë vendit duhet të jenë të njohura paraprakisht nga institucioni përgjegjës për njehësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi).
2. Të kenë aftësi shumë të mira komunikuese.
3. Të kenë njohuri bazë në përdorimin e kompjuterit.

4. Të kenë njohuri bazë mbi zhvillimin bujqësor dhe rural në Shqipëri dhe mbi politikën e përbashkët për bujqësinë me BE-në.
5. Të kenë përvojë pune ose internshipi/ praktika profesionale.

Kandidatët do të testohen në lidhje me:

- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9817, datë 22.10.2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”.
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 37/2015, "Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian për rregullat e zbatimit të mbështetjes financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II).
- Njohuritë mbi Marrëveshjen Sektoriale ndërmjet Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian që përcakton dispozitat e menaxhimit dhe zbatimit të asistencës financiare të BE-së, për Shqipërinë në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Para-anëtarësimit në fushën "Bujqësia dhe Zhvillimi Rural" (IPARD).
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9367, datë 7.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
- Njohuritë mbi VKM nr. 719, datë 31.10.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, i ndryshuar.

- **SPECIALIST SEKTORI I PROMOCIONIT DHE KOMUNIKIMIT** (kontratë pune 6h/ditë) kategoria IV-b

Detyrat kryesore të Specialistit të promocionit dhe komunikimit janë:

1. Asiston në përgatitjen e çdo informacioni mbi aktivitetet dhe trajnimet e ndryshme që realizohen.
2. Përditëson rubrikat e website: azhbr.gov.al; ipard.gov.al.
3. Përgatit dhe koordinon prodhimin e materialeve të printuara.
4. Merr pjesë në hartimin e materialeve promovuese dhe shërbimet gjatë ngjarjeve.

Kandidatët e interesuar duhet të përmbushin këto kritere:

1. Të ketë përfunduar studimet e larta universitare, Master Profesional, në Shkenca Shoqërore. Edhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë. Diplomat e njohura jashtë vendit duhet të jenë të njehësura nga institucioni përgjegjës sipas legjislacionit në fuqi.
2. Mbajtësi i këtij pozicioni duhet të ketë të paktën 1 vit eksperiencë punë në profesion.
3. Të kenë aftësi shumë të mira komunikuese.
4. Të kenë njohuri bazë në përdorimin e kompjuterit.
5. Të kenë njohuri bazë mbi zhvillimin bujqësor dhe rural në Shqipëri dhe mbi politikën e përbashkët për bujqësinë me BE-në.
6. Të kenë përvojë pune ose internshipi/ praktika profesionale

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë brenda datës **14.10.2020, ora 16:30** në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (Adresa: Rruga “Muhamet Gjolleša”, Nr. 56, Tiranë): Kërkesën për punësim ku duhet të përcaktojnë pozicionin për të cilin po aplikojnë; një kopje të CV të përditësuar; diplomën e noterizuar; certifikata dhe kualifikime të ndryshme; një fotokopje e librezës së punës; një kopje të ID-së; formularin e vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore të firmosur nga aplikuesi; raportin mjeko-ligjor.

TË GJITHË KANDIDATËT QË APLIKOJNË PËR POZICIONET E MËSIPËRME, DO TË MARRIN INFORMACION VETËM NË FAQEN E INTERNETIT TË AZHBR www.azhbr.gov.al, PËR FAZAT E MËTEJSHME TË KËSAJ PROCEDURE:

- për rezultatet e verifikimit
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi (testim me shkrim/ intervista me gojë)
- shpalljen e listës së fituesve

Për të marrë këto informacione, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e internetit të AZHBR www.azhbr.gov.al.

AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL